

PROJEKTLIGJ

“Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014 ‘Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë’”.

Në mbështetje të nenit 81 dhe nenit 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të Rregullores së Kuvendit, paraqitet për shqyrtim dhe miratim ky projektligj:

Neni 1

Në nenin 48 të ligjit nr. 92/2014 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Norma standarde prej 20 % zbatohet për të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në nenin 49 dhe nenin 49/1 të këtij ligji.”

Neni 2

Pas nenit 49 shtohet neni 49/1 me këtë përmbajtje:

Neni 49/1

“Norma zero e TVSH-së për furnizimin e produkteve të shportës bazë të konsumit”

1. Furnizimi i mallrave që bëjnë pjesë në shportën bazë të konsumit tatohet me normë zero të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.
2. Në kuptim të këtij ligji, produktet e shportës bazë të konsumit përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - a) bukë dhe produkte të drithërave;
 - b) qumësht dhe nënprodukte të tij;
 - c) vezë;
 - d) mish dhe nënprodukte të mishit;
 - e) peshk dhe produkte peshku;
 - f) fruta dhe perime;
 - g) vaj ushqimor;
 - h) sheqer.
3. Lista e detajuar e produkteve, kodet përkatëse të nomenklaturës së kombinuar, si dhe kriteret për klasifikimin e tyre, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
4. Subjektet e tatueshme që kryejnë furnizime sipas këtij neni kanë të drejtë të zbresin Tatimin mbi Vlerën e Shtuar të paguar në blerje, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
5. Administrata tatimore përcakton, me udhëzim, procedurat për zbatimin e këtij neni dhe kontrollin e abuzimeve të mundshme.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

RELACION SHPJEGUES

Për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 ‘Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë’”

I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Ky projektligj synon të lehtësojë barrën fiskale mbi konsumatorët shqiptarë për produktet bazë të ushqimit, nëpërmjet aplikimit të normës zero të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

Objektivat kryesore janë:

- rritja e përballueshmërisë së ushqimeve bazë për familjet shqiptare;
- mbrojtja e fuqisë blerëse;
- mbështetja e shtresave me të ardhura të ulëta dhe të mesme;
- zbutja e ndikimit të inflacionit në produktet bazë të konsumit.

II. VLERËSIMI NË RAPORT ME INTEGRIMIN NË BE

Legjislacioni aktual parashikon një normë standarde TVSH-je prej 20%, ndërsa produktet bazë ushqimore në shumicën e rasteve taten me këtë normë.

Megjithatë:

- barra fiskale mbi shportën bazë mbetet e lartë;
- TVSH reflektohet drejtpërdrejt në çmimin final për konsumatorin;
- praktika në disa vende të Bashkimit Evropian lejon aplikimin e normave shumë të reduktuara ose zero për produkte bazë apo produktet e shportës.

III. ARGUMENTIMI DHE EFEKTET E PRITSHME

Ky ndryshim në ligj:

1. Mbron konsumatorin pasi ulja e TVSH-së në zero për produktet bazë pritet të reflektohet në uljen e çmimeve dhe rritjen e aksesit në ushqim.
2. Lufton drejtpërdrejt varfërinë duke u kthyer në një masë që ndihmon veçanërisht:
 - familjet me të ardhura të ulëta;
 - pensionistët;
 - grupet vulnerabël.
3. Ndikon në stabilizimin e tregut, duke kontribuar në stabilizimin e çmimeve dhe uljen e presioneve inflacioniste në sektorin ushqimor.

IV. LIGJSHMËRIA DHE KUSHTETUTSHMËRIA

Projektligji është në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- parimet e barazisë dhe proporcionalitetit në taksim;
- legjislacionin ekzistues tatimor.

V. PËRAFRIMI ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE



Direktiva e TVSH-së e Bashkimit Evropian (Direktiva 2006/112/EC, e ndryshuar, Neni 98), lejon aplikimin e normave të reduktuara e në raste të veçanta edhe norma zero për kategori të caktuara, përfshirë produkte ushqimore bazë, uji i pijshëm, produktet farmaceutike, etj (Lista e plotë në ANNEX III të Direktivës. Në këto kushte, ky projektligj jo vetëm që nuk bie ndësh me Aktet e Bashkimit Evropian, përkundrazi është në përputhje me parashikimet e tyre.

VI. PËRMBLEDHJE E NENEVE

Projektligji parashikon:

- saktësimin e normës standarde në nenin 48;
- shtimin e nenit 49/1 për normën zero;
- përcaktimin e kategorive bazë të produkteve;
- delegimin e listës së detajuar te Këshilli i Ministrave;
- garantimin e të drejtës së zbritjes së TVSH-së.

VII. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Ngarkohen për zbatimin e këtij ligji:

- Ministria e Financave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Këshilli i Ministrave (për aktet nënligjore).

VIII. NDIKIMI BUXHETOR

Zbatimi i këtij projektligji pritet të sjellë:

- ulje të të ardhurave nga TVSH në afat të shkurtër;
- mundësi kompensimi përmes rritjes së konsumit dhe formalizimit të tregut;

Efekti neto kërkon vlerësim të detajuar nga Ministria e Financave.

IX. PËRFUNDIME

Projektligji synon:

- rritjen e mirëqenies së qytetarëve;
- uljen e kostos së jetesës;
- përmirësimin e aksesit në ushqime bazë.

Në këtë kuadër, propozohet miratimi i tij nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Përgatiti Relacionin:

Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”

Propozuese

Ana Dajko